



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 13 , DATË 23 / 07 /2024

**PËR MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK
PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “BOGA
VALLEY RESORT” ME SUBJEKT APLIKUES BOGA VALLEY RESORT SHPK,
NUIS M37703701A**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 17, nenit 18 dhe nenit 21 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Projekti i investimit parashikon ndërtimin e një resorti turistik, ku do të ketë një hotel dhe disa vila, së bashku me ambientet e shërbimit në Bashkinë Malësi e Madhe. Ndërtimi është parashikuar të jetë i kombinuar me punime guri dhe druri në harmoni me natyrën.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 5,100,000 Euro (pesë milion e njëqind mijë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 90 (nëntëdhjetë) punonjës.
- Projekti do të realizohet në një sipërfaqe totale prej 12,68 ha, në ZK 1237, Bogë, Shkrel, Bashkia Malësi e Madhe, pronë “shtet”, përkatësisht në pasuritë me nr. 3/1 me sipërfaqe 2,69 ha dhe nr. 35 me sipërfaqe 9,99 ha. Subjekti ka një marrëveshje qiraje për pasurinë me nr. 1 me sipërfaqe 0,3 ha, pronë private për të cilën dëshmon me dokumentacion

marrëdhënien me pronën.

- Projekti realizohet nga subjekti Boga Valley Resort Shpk me NUIS M37703701A.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” për projektin e investimit “Boga Valley Resort”, status ky i kushtëzuar me dorëzimin e projektit të rishikuar, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me kriteret zhvillimore të zonës, parashikuar në dokumentat e miratuar të planifikimit e zhvillimit të territorit, duke u bazuar gjithashtu në parashikimet e legjislacionit për zonat e mbrojtura, Planit të Përgjithshëm Vendor Malësi e Madhe dhe Planit të Detajuar Vendor.
2. Statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” i jepet projektit të investimit “Boga Valley Resort”, për një periudhë 1 (një) vjeçare dhe përgjatë kësaj periudhe subjekti është i detyruar të dorëzojë projektin e rishikuar.
3. Në rast mosdorëzimi të projektit brenda këtij afati ky vendim nuk prodhon asnjë efekt ligjor.
4. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 21 i Ligjit Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i miratohen projektit janë si më poshtë:
 - a) Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
5. Për masat mbështetëse të kërkuara, përfshirë dhe vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore me sipërfaqe totale 12,68 ha, kjo masë do duhet të rishqyrtohet sërish nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), pas dorëzimit të projektit të rishikuar nga subjekti, sipas pikës 2 të këtij vendimi.
6. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Boga Valley

Resort” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.

7. Ngarkohet subjekti Boga Valley Resort Shpk me NUIS M37703701A për dorëzimin e projektit të rishikuar në përputhje me kriteret mjedisore të zonës.
8. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të asistojnë subjektin për rishikimin e projektit dhe përputhjen me kriteret mjedisore të zonës.
9. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorimin e zbatimit nga ana e autoriteteve publike të masave të përfshira në Planin e Veprimit, të miratuar me këtë vendim.
10. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
11. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

ERVIN METE

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “BOGA VALLEY RESORT”

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza.

2. Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet dhe dokumentat e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

3. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Boga Valley Resort”

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit “**Boga Valley Resort**”, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit “**Boga Valley Resort**” është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të

veprimet për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

4. Hapat procedurale

Investitori Boga Valley Resort Shpk me NUIS M37703701A kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin, ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar ne faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
MTM dhe AKZM të asitojnë subjektin lidhur me rishikimin e projektit dhe përputhjen me kriteret mjedisore të zonës.		MTM AKZM	MTM dhe AKZM të asitojnë subjektin lidhur me rishikimin e projektit dhe përputhjen me kriteret mjedisore të zonës.	Brenda afatit të sipërpërmendur	1 vit	
Vënia në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore.		KIS	Kjo masë do të rishqyrtohet sërish nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), pas dorëzimit të projektit nga ana e subjektit.			
Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;	Po	AIDA dhe organe të tjera kompetente	Ligj 55/2015 i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim		Sipas legjislacionit të investimeve strategjike.	
Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve,		AIDA dhe organe të tjera	Kjo masë do të rishqyrtohet sërish nga Komiteti i Investimeve Strategjike			Në varësi të

licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike.		kompetente.	(KIS), pas dorëzimit të projektit nga ana e subjektit.			legjislacionit sektorial për llojin e lejes, licencës dhe autorizimit
Mbështetje me infrastrukturë ndihmëse, rehabilitim të rrjetit elektrik, zgjerim dhe përmirësim i rrugës Burgu Recit – Fushë Okol, si dhe realizimin e rrjetit të ujësjellësit në atë zonë.			Kjo masë do të rishqyrtohet sërish nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), pas dorëzimit të projektit nga ana e subjektit.			Aksesi në infrastrukturë të mundësohet nga subjekti

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

ERVIN METE

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
LAURA PLAKU (SARO)